



# RÖFIX Malta Fina

Fino me bazë gëlqere

## Udhëzime teknike dhe liqjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

## Fushat e përdorimit:

E gatshme për përdorim, përbërje minerale, jo hidrofobe, me gërryerje të imët për ambiente të brendshme, mbi suvatime.

Përdorni një shtresë boje të përshtatshme .


Nuk është i përshtatshëm për ngjitësat me bazë cemento.

## Karakteristikat:

- I gatshëm për aplikim
- Përshkueshmëri e lartë
- Gëlqere e shuar sipas EN 459-1
- Rritja e sasisë së silicit 0/1 sipas EN 13139

## Përpunimi:



Të dhëna teknike	
SAP-Art. Nr.:	2000693418
NAV-Art. Nr.:	118417
Lloji i paketimit	
Njesi per palete	48 Nj./Pal
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Ngjyra	e bardhë
Struktura e suvasë	F
Kokrrizimi	0 - 0,6 mm
Konsumi	ca. 3,5 kg/m <sup>2</sup>
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Trashësia e shtresës	max. 3 mm
Trashësia minimale e suvasë	1 mm
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	ca. 1.700 kg/m <sup>3</sup>
Përçueshmëria ndaj avujve të ujit $\mu$	ca. 8
Vlera e pH	ca. 12
Kapaciteti termik	ca. 1 J/kg K
Forca në shtypje (28 d)	1 N/mm <sup>2</sup>
Koha e tharjes	> 14 d
Këshilla për paketimin	Ne thase te riciklueshem PE
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 35 °C
Reaksioni ndaj zjarrit	A1 (EN13501-1)

## Baza e materialit:

- Gëlqere e shuar e ruajtur minimumi 3 muaj.
- Rërë mermeri e bardhë e selektuar

## Kushtet e punimit:

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes temperatura e ambientit përreth dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe ngrihet mbi +35 °C.



## RÖFIX Malta Fina

Fino me bazë gëlqere

<b>Bazamenti:</b>	Bazamenti duhet të mos ketë papastërti dhe pluhur. Suvate mbushëse me bazë çimento/gëlqere mund të suvatohen pas ngurtësimit. Suvatë mbushëse me bazë gipsi duhet të jenë të thata dhe të forta plotësisht.
<b>Bazamenti Trajtimi paraprak:</b>	<b>Suva mbushëse me bazë gëlqere:</b> I përshtatshëm <b>Suva mbushëse me bazë gëlqere /çimento:</b> I përshtatshëm <b>Suva mbushëse e lehtë:</b> Si suva niveluese (Renostar/Renoplus) <b>Suva termoizoluese:</b> Si suva niveluese (Renostar/Renoplus) <b>Beton:</b> Mos e përdorni në këto bazamente <b>Sisteme të izolimit termik, suva të izolimit termik, bazamente elastike:</b> Mos e përdorni në këto bazamente <b>Suva e vjetër me bazë minerale e palyer:</b> Si suva niveluese (Renostar/Renoplus) <b>Suva e vjetër me bojë minerale:</b> Mos e përdorni në këto bazamente <b>Suva e vjetër organike:</b> Mos e përdorni në këto bazamente <b>Suva mbushëse me bazë allçije e thatë:</b> I përshtatshëm <b>Pllaka karton gipsi:</b> Mos e përdorni në këto bazamente <b>Pllaka allçije me fibra letre (p.sh. Fermacell):</b> Mos e përdorni në këto bazamente
<b>Bazamenti-Trajtimi paraprak:</b>	Bazamentet me aftësi të lartë thithëse duhet të lagen paraprakisht me ujë, ose të lyhen me një shtresë astar, duke njëtrajtëzuar kështu aftësitë thithëse (përvec suvave me bazë gipsi). Në bazamentet e forta dhe jo me aftësi thithëse (psh. ngjitës) si dhe në sipërfaqet e lëmuara (psh suva gipsi të lëmuara) produkti (thes 25-kg) rreth 0,25 - 0,5 kg RÖFIX ngjitës Flex ekstra. Tek suvatë me bazë gips- gëlqere (suva mbuluese) duhet të aplikoni paraprakisht astarin (psh. RÖFIX PP 301 HYDRO LF).
<b>Përgatitja:</b>	Produkt i gatëshëm për përdorim
<b>Përpunimi:</b>	Shtrimi kryhet nëpërmjet një mistrie inoksi të lëmuar. Mbi suva të poshtme të thata, sugjerohet një përpunim 2 shtresor „e fresket mbi të fresket“ (trashësia e suvasë max 3 mm). Me këtë metodë përpunimi arrihet, si rregull imazhi strukturor më i bukur. Strukturimi si suva e imët: fërkojeni në mënyrë të njëtrajtshme me shajakun e përshtatshëm ose me copë sfungjeri fërkuese. Bojë gëlqerore e shuar e mundur me tekniken al fresco (dmth bojë gëlqerore me malta fina të lagësht).
<b>Këshilla në rast reziku:</b>	Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
<b>Keshilla per perpunimin:</b>	Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Shtresa ose tapete mund të shtrohen vetëm mbas forcimit të plotë të produktit (rreth 4 javë). Gjatë tharjes duhet të përdorni mjete për ngrohjen- që të krijohen kushte më të mira për tharjen dhe fortësimin (psh. me ventilues). Ngrohja e drejtpërdrejtë e suvasë nuk është e lejuar. Tharje të detyrueshme (psh nëpërmjet përdorimit të aparateve tharës) nuk duhet të përdoren në asnjë rast, për një tharje më të shpejtë, duke qenë se kjo sjell humbje të qëndrueshmërisë si dhe plasaritje të shumta të imta (qëndrueshmëria ndaj gërryerjes mënjanohet nga kjo). Vonesa të mëdha të tharjes mund të çojnë gjithashtu në uljen e qëndrueshmërisë (psh punime ndërtimi në dimër pa ngrohje natën ose atje ku mungon korrenti) Gjatë tharjes mbrojeni nga kondesimi i sipërfaqes.
<b>Magazinimi:</b>	Magazinoini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë. E mbyllur, e magazinueshme pa kufi.



## RÖFIX Malta Fina

Fino me bazë gëlqere

### Këshilla të përgjithshme:

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.

Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.

Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar.

Tek finot pastoze forca në shtypje duhet të jetë minimumi 1,5 N/mm<sup>2</sup>. Mos e përdorni në bazamente të lagështa dhe jo mbi sipërfaqe që janë në kontakt të shpeshtë me ujin. Nuk mund të thuhet se mund të kemi një tharje të bazamentit dhe pa njolla për shkak të kushteve të objektit dhe motit. Për shkak të përdorimit të lëndëve të para natyrore ndryshime të vogla të ndryshimit të ngjyrës janë të mundshme. Objektet që janë të lidhur me njëri tjetrin duhet të lyhen nga i njëjti furnizim/ porosi që të shmangim diferencat në ngjyrë. Në rast se do punohet me të njëjtën ngjyrë për një kohë të gjatë në kantier duhet ti jepet prodhuesit data e porosisë së parë. Materialet e magazinuara mund të shkaktojnë ndryshim ngjyre. Ju lutem përpara aplikimit kontrolloni ngjyrën. Ankesat e mëvonshme nuk mund të merren parasysh.

Agjentët atmosferikë, rrezet UV, ekspozimi nga lagështia ndryshojnë sipërfaqen me kalimin e kohës. Ndryshime të dukshme të ngjyrës janë të mundshme. Ky proces ndryshimi ndikohet nga materiali dhe kushtet e objektit.

Kur fasada nuk është tharë ende, vesa, shiu mund të depozitohen në sipërfaqe. Efekti është i ndryshëm në varësi të intensitetit të ngjyrës i cili ndryshon. Dhe nuk ka ndikim në cilësinë e produktit. Efektet zhduken nga erozioni.

Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.

Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantiere duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (+20 °C/65 % Lagështirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë.

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.